



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2020:017681

Datë: 20.02.2024

Numri i dokumentit: 05388031

**Ac.nr.5012/2021**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hysni Bardheci – kryetar i kolegjit, Bujar Muzaqi dhe Enes Mehmeti, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS), me seli Prishtinë, kundër të paditurit Z.B., nga fshati M., Komuna e Malishevës, me objekt kontesti për rimbursim dëmi, vlera e kontestit 715.00 euro, duke vendosur sipas ankesës së të paditurit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, Dega në Malishevë, C.nr.49/2020, të datës 31.05.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 20.02.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** e pa themeltë ankesa e të paditurit Z.B., nga fshati M., Komuna e Malishevës, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë, Dega në Malishevë, C.nr.49/2020, i datës 31.05.2021, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykatës Themelore në Gjakovë, Dega në Malishevë, me aktgjykimin e atakuar C.nr.49/2020, të datës 31.05.2021, ka vendosur që të **MIRATOHET** kërkesë-padia e paditësit Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në Prishtinë Rr “Lidhja e Pejës”, Magj. Prishtinë- Fushë Kosovë, pa.nr. në tersi si e bazuar, dhe të **DETYROHET** i padituri Z.S.B. nga fshati M., Komuna e Malishevës t’ia kompensoj shumën prej 715.00 euro në emër të rimbursimit të dëmit material dhe jo material të shkaktuar të dëmtuarës A.B., me kamatë përkatëse ligjore prej 8% e cila fillon të rrjedhë nga nxjerrja e aktgjykimit datë 31.05.2021 e deri në përmbylljen definitive të detyrimit, si dhe shpenzimet procedurale në shumën prej 20 euro të gjitha këto në afat prej 15 (ditësh) pas plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka parashtruar ankesë i padituri dhe atë për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që të aprovet si e bazuar

ankesa e të paditurit dhe të priset aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë, Dega në Malishevë, C.nr.49/2020, i datës 31.05.2021, dhe lënda t'i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim dhe vendosje të serishme.

Paditësja nuk ka paraqitur përgjigje në ankesën e të paditurit.

Gjykata e Apelit e Kosovës si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS), me seli në Prishtinë, me datë 04.02.2020, në Gjykatës Themelore në Gjakovë, Dega në Malishevë, ka paraqitur padi, kundër të paditurit Z.B., nga fshati M., Komuna e Malishevës, për rimbursimin e dëmit. Në referatin e padisë ka parashtruar së i padituri me datë 16.07.2015, rreth orës 15.50, në Malishevë, ka shkaktuar aksident trafiku me automjetin VW Golf 2, me targa ..., dhe si pasojë e këtij aksidenti ka pësuar dëm A.B. Ka theksuar së automjeti i cili ishte shkaktar i aksidentit në momentin e shkakimit të aksidentit ka qenë pa mbulesë siguroese, respektivisht me afat të skaduar të policës së sigurimit. Ndërsa paditësja duke i respektuar dispozitat e Ligjit të 04/L-018 për Sigurim të Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia, dhe të dispozitave të LMD-së, të dëmtuarës A.B., ia ka kompensuar dëmin e pësuar në këtë aksident. Në fund ka kërkuar që t'i ribursohet shuma prej 715.00 euro, të cilën shumë paditësja ia ka kompensuar të dëmtuarit, me arsyetim se i padituri ka qenë shkaktar i aksidenti dhe se i njëjti nuk ka pasur sigurim.

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin C.nr.49/2020, të datës 22.06.2020, e ka detyruar të paditurin që në afat prej 15 ditëve të paraqet përgjigje në padi, duke e paralajmëruar të njëjtin edhe për pasojat e mos paraqitjes së përgjigjes në padi, ndërsa i padituri nuk ka parashtruar përgjigje në padi, kështu që gjykata e shkallës së parë duke konsideruar se janë plotësuar kushtet ligjore konform nenit 150.1 të LPK-së ka marrë aktgjykim për shkak të padëgjueshmërisë duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar gjykata ka konstatuar se i padituri me datën 03.06.2020, personalisht e ka pranuar aktvendimin për përgjigjen në padi, dhe padinë me provat materiale, mirëpo edhe pse ka kaluar afati i paraparë për dhënien e përgjigjes në padi, i njëjti nuk e ka parashtruar përgjigjen në padi, andaj duke i bazuar në dispozita ligjore të nenit 150 al.1 pika (a), (b) dhe (c), të LPK-së të lartë cituar gjykata e shkallës së parë ka marrë aktgjykim për shkak të pa dëgjueshmërisë (mosbindjes) pasi që janë plotësuar kushtet si me poshtë vijojnë: a) Të paditurit i është dorëzuar në mënyrë të rregull padia, provat materiale dhe thirrja-Aktvendimi për dhënien e përgjigjes në padi, b) Themelësia e kërkesë padisë rezulton nga faktet e treguar në padi, dhe c) Faktet mbi të cilat mbështet kërkesë-padia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vet paditësi. Vendimin mbi shpenzimet e procedurës e ka bazuar në nenin 452 paragraf.1 të LPK-së me ç' rast palës paditëse i janë pranuar shpenzimet në emër të taksës gjyqësore për padi.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar, nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i kanë pretenduar palët ankuese me ankesë

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurit së gjykata e shkallës së parë ka bërë vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, pasi që e njëjta vendimin e ka bazuar në provat të cilat paditësja ia ka bashkangjitur padisë bazuar në nenin 150 al.1 pika (a), (b) dhe (c), të LPK-së, ndërsa i padituri nuk e ka kontestuar kërkesëpadinë e paditësit edhe përkundër faktit së të njëjtit i është dorëzuar personalisht padia me prova me detyrim për të dhënë përgjigje në padi. Në rastin konkret është vërtetuar së shkaktar primar i aksidentit të datës 16.07.2015, i cili ka ndodhur në rrugën "...", në Malishevë, ka qenë i padituri, ku përveç dëmeve materiale lëndime trupore kanë pësuar A.B. dhe B.H.. Në momentin e aksidentit automjeti VW Golf 2, me targa ..., të cilën e drejtonte i padituri nuk ka pasur policë valide të sigurimit, pasi që policia e sigurimi i kishte skaduar me datë 17.06.2015. Ky fakt vërtetohet nga raporti i aksidentit me nr.2015-ED-324, të datës 16.07.2015, dhe aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë PP.nr.936/2015, datë 11.11.2015. Për me tepër, i paditura as përmes ankesës nuk e ka kontestuar faktin së i njëjti është shkaktar primar i aksidentit.

Në bazë të vendimit të komisionit të shkallës së parë për trajtimin e dëmeve nr. FK-1980/2017, të datës 21.02.2018, rezulton se komisioni për trajtimin e dëmeve i paditëses kishte shqyrtuar kërkesën për kompensimin e dëmit për shkak të lëndimeve të pësuar në aksidentin e datës 16.07.2015, të paraqitur nga A.B., dhe pasi që kishte marrë parasysh të gjitha provat që gjinden në shkresat e lëndës, kishte ardhur në përfundim së kemi të bëjmë me përgjegjësi të ndarë në shkaktimin e aksidentit, ku 80% të përgjegjësisë e ka i padituri, ndërsa 20% të përgjegjësisë drejtuesi i automjetit B, për shkak të tejkallimit të shpejtësisë, dhe për 80% të përgjegjësisë, të dëmtuarës A.B., e cila në bazë të vlerësimit mjekësor të datës 11.01.2018, ishte konstatuar së ka pësuar dëmtime të lehta trupore, ia ka njohur shumën prej 500.00 euro, si dhe shpenzimet e avokatit në shumë prej 215.00 euro, gjithsej në shumë prej 715.00 euro.

Gjykata gjeti se përmes ujdisë jashtëgjyqësore të lidhur me datë 23.02.2018, në mes të Byrosë Kosovare të Sigurimit dhe A.B., është arritur marrëveshja që pala e dëmtuar në këtë aksident, për dëmin e pësuar material dhe jomaterial t'i kompensohet shuma prej 500.00 euro, shpenzimet e procedurës në shumë prej 215.00 euro, gjithsej në shumë prej 715.00 euro. Në bazë të urdhërtransferit nr.1980/2017, të datës 23.02.2018, rezulton së drejtori i departamentit të fondit të kompensimit të dëmeve, i është drejtuar UD drejtorit të departamentit të financave në BKS, me urdhëresë që në emër të zhdëmtimit t'i paguhet palës së dëmtuar A.B., shuma prej 715.00 euro, në afatin e paraparë me ujdi. Ndërsa nga konfirmimi i transferit bankar i datës 27.02.2018, rezulton së shuma në vlerë prej 715.00 euro, ka kaluar llogarinë bankare të të autorizuarit të palës së dëmtuar A.B..

Me dispozitën e nenit 18 par.1 të Ligjit nr. 04/L-018 për sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia përcaktohet se: *“Personi i dëmtuar të cilit i është shkaktuar dëmi brenda territorit të Republikës së Kosovës nga një mjet motorik, pronari i të cilit nuk është i mbuluar nga sigurimi i auto përgjegjësise, ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblimin e dëmit nga Byroja”*. Kurse me par.4 të po këtij neni parashihet se: *“Byroja ka të drejtë regresi për këto dëme nga personi përgjegjës dhe atë për shumën e paguar, shpenzimet dhe kamatat”*. Ndërsa në bazë të nenit 136 par. 1 të Ligji Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, është paraparë së *“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*.

Në bazë të dispozitës së sipërcituar, paditësja është përgjegjëse për kompensimin e dëmit personave të dëmtuar nga automjetet pronaret e të cilëve nuk janë të mbuluar nga sigurimi i autopërgjegjësise. Në rastin konkret është vërtetuar së paditësja e ka kompensuar palën e dëmtuar në aksidentin në fjalë, andaj e njëjta ka të drejtën e regresit ndaj të paditurit si person përgjegjës për shkaktimin e dëmit dhe atë për shumën e paguar shpenzime dhe kamatën. Gjykata vlerëson se i padituri ka për detyrë që ta bëjë kompensimin e dëmit të cilin e ka shkaktuar në aksident, pasi që automjeti me të cilin është shkaktuar aksidenti nuk ka pasur sigurim. Andaj bazuar në dispozitat e lartcekura Gjykata e Apelit vlerëson së gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Sa i përket pretendimi të të paditurit të paraqitur në ankesë së lidhur me këtë rast është vendosur nga Gjykata Themelore në Gjakovë, Dega në Malishevë, me marrëveshje gjyqësore të datës 23.04.2021, në lëndën C.nr.168/2018, ku i padituri është obliguar që paditëses t’ia paguaj shumën prej 316.00 euro dhe së kemi të bëjmë me çështje të gjykuar, kjo gjykatë vlerëson së ky pretendim është i paqëndrueshëm pasi që i padituri ankesës nuk ia ka bashkangjitur asnjë provë për të vërtetuar këtë fakt kur dihet që dëmi që i është kompensuar të dëmtuarit në këtë rast nuk është 316.00 euro, por 715.00 euro. Për me tepër, fakti së sipas paditësit e paditura i ka ngritur dy padi njëra me numër të lëndës C.nr.168/2018, dhe tjetra me numër C.nr.49/2020, nuk mund të konsiderohet si rrethanë që kemi të bëjmë me çështje të njëjtë pasi që siç rezulton nga raporti i aksidentit, në aksidenti e datës 16.07.2015, përveç të dëmtuarës A.B., lëndime trupore ka pësuar edhe Blerim Hoti, dhe po ashtu janë shkaktuar edhe dëme materiale në të dy automjetet. Andaj për të vërtetuar këtë pretendim paditësi është dashur që të paraqes prova pasi që në mungesë të provave një pretendim i tillë konsiderohet i pabazuar.

Ndërsa lidhur me pretendimin e të paditurit të paraqitur në ankesë sa i përket parashkrimit të kërkesës, Gjykata e Apelit vlerëson së i padituri këtë pretendim ka pasur mundësi ta paraqet përmes përgjigjes në padi pasi që në bazë të fletë kthesës postare të datës 03.06.2020, rezulton së të paditurit i është dorëzuar padia me prova, dhe sipas nenit 180 par.3 të LPK-së, prapësimi i parashkrimit që nuk është paraqitur në gjykimin e shkallës së parë, nuk mund të paraqiten me ankesë. Mirëpo, edhe po që se i padituri do ta paraqiste prapësimin e parashkrimit me përgjigje në padi, në këtë rast gjykata vlerëson së nuk kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesë pasi që nga momenti kur paditësja e ka kompensuar palën e dëmtuar përmes transferit bankar të datës 27.02.2018, e deri me datën e paraqitjes së padisë në gjykatë datë 04.02.2020, nuk kanë kaluar tre (3) vite ashtu siç është përcaktuar me nenin 362 të LMD-së, në mënyrë që të konsiderohet që kërkesa e paditëses është parashkruar.

Vendimi për kamatën është i drejtë dhe gjënë mbështetje në dispozitat e nenit 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, sipas të cilës dispozitë është paraparë së “*Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhi t kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë*”.

Po ashtu edhe vendimi për shpenzimet gjyqësore është i drejtë dhe gjen mbështetje në nenin 449 dhe 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, kurse lartësia e shpenzimeve të aprovuara nga gjykata e shkallës së parë i referohet shpenzimeve për taksën gjyqësore për padi në shumën prej 20.00 euro.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti së gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

#### GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.5012/2021, datë 20.02.2024

Kryetar i kolegjit, Gjyqtari  
Hysni Bardheci